

GREEN COAST SH.P.K.
RRUGA TISH DAIJA, KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1, TIRANË ,SHQIPËRI
L41329038D

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 03.11.2025 në orën 12.00, në selinë e Shoqërisë "Green Coast" sh.p.k., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L41329038D, me adresë në Rruga Tish Daija, kompleksi Kika 2, godina 3, kati 1, Tiranë, Shqipëri (më tej referuar si "**Shoqëria**"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

BALFIN - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga "Papa Gjon Pali II", Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 038523830 dhe me nr. Personal: I35203147R, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (ne vijim identifikuar si "**Ortaku i Vetëm**").

Znj. Edlira MUKA e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Znj. Migena Kolonja, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

Meqenëse në mbledhje janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, mbledhja diskuton rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtroi se kapitali aktual i Shoqërisë është 6,050,838,988 LEK (Gjashtë miliardë e pesëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë lekë).

Në kushtet kur veprimtaria e Shoqërisë ka performuar kënaqshëm dhe situata financiare është në përputhje me pritshmëritë, është propozuar nga ana e Ortakut të Vetëm zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë në vlerën prej 14,433,974 Euro (katërmëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër euro), e barasvlerëshme me shumën në LEK 1,398,940,760 (Një miliard e treqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e dyzet mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë lekë) sipas kursit të këmbimit 96.92 të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOSI:


- A. Miratimin e zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 14,433,974 Euro (katërmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër euro), e barasvlershme me shumën në LEK 1,398,940,760 (Një miliard e treqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e dyzet mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë lekë) sipas kursit të këmbimit 96.92 të publikuar nga Banka e Shqipërisë.
- B. Bazuar në sa më sipër zvogëlimi i kapitalit do të konsiderohet Kontribut ne Para dhe i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- C. Si rezultat i miratimit të Zvogëlimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 6,050,838,988 LEK (Gjashtë miliardë e pesëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë lekëlekë), bëhet 4,651,898,228 leke (Katër miliardë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e tetë lekë).
- D. Te autorizojë Administratorin e Shoqërisë, ose çdo personi tjetër rregullisht të autorizuar prej tij për zbatimin e vendimeve si me sipër perfshire ketu edhe kryerjen e te gjitha transaksioneve bankare te kerkuara dhe te nevojshme per permbushjen dhe per zbatimin e vendimeve si me sipër.

Megjenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 12.30. Ky vendim i Asamblesë së Përgjithshme mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
GREEN COAST SH.P.K.

Ortaku i Vetëm

BALFIN-Balkan Finance Investment Group Sh.p.k


Përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor

Znj. Edlira MUKA



BALFIN - Balkan Finance
Investment Group sh.p.k.

Rruga "Papa Gjon Pali II",
ABA Business Center, Kati 11, Tiranë
Nipt: K72223031K

Sekretar
Migena KOLONJA

